



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.363/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Rafet Haxhaj dhe Zyhdi Haziri anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me ankesën e Diellza Bllaca nga Fushë Kosova, rruga “Zahir Pajaziti”, nr.3/2 Fushë Kosovë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me seli në Prishtinë, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.10.2017, mori këtë:

#### V E N D I M

**HUDHET** si e palejuar ankesa e parashtruar nga Diellza Bllaca nga Fushë Kosova me shenjën ZL.A.nr.357/2017 e datë 23.10.2017, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

#### A r s y e t i m

Me datën 23.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Diellza Bllaca, me të cilën ka theksuar se me datë 22.10.2017, ka shkuar për të votuar por në listën e votimit nuk është gjetur emri i saj edhe pse me datë 30.09.2017 i ka mbushur 18 vjet. Pasi që nuk ka mundur të votoj me rregull i është dashur që të votoj me kusht, mirëpo vëzhguesit e Qendrës së votimit i kanë thënë se “ke votuar kot”. Me këtë rast nga PZAP, ka kërkuar që ti njihet vota e saj.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

#### **Ankesa është e pa lejuar**

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar, në ankesë sepse, pretendimet ankimore që ndërlidhen me rezultatin e votimit duhet të parashtrohen me rastin e publikimit të shpalljes së rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës.

Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankueses. Hudhja e ankesës së ankueses Diellza Bllaca, nuk e paragjykon çështjen dhe ankueses nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesë tjetër, pas shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
ZL. Anr.363/2017 më datën 24.10.2017.



**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*